



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 1230/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Bujar Haradinaj – Kandidat për Anëtar të Kuvendit Komunal nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërin e Kosovës (AAK) dega në Gjakovë, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, në Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, morri këtë:

#### **VENDIM**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Bujar Haradinaj – Kandidat për Anëtar të Kuvendit Komunal nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërin e Kosovës (AAK) dega në Gjakovë,

#### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 15:43 nga parashtruesi i ankesës Bujar Haradinaj (AAK) ku pretendohet se, në QV 0209C/01C, 0209C/02C kandidati për AAK i ka marrë 7 vota, ndërsa në procesverbalin e KKZ-së del se ka 0 vota. Më tutje ka shtuar se këto vota kanë shkuar tek kandidati me nr.25 dhe për këtë dyshon se e ka bërë njëri nga komisionarët e QV i cili është i afërt i familjes së tij. Parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur disa formularë të rezultateve për kandidatë për kuvend komunal.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

#### **ankesa është e pabazuar**

Me ankesën e parashtruar nga Bujar Haradinaj (AAK), pretendohet se në QV 0209C/01C, 0209C/02C ka pasur pa rregullsi gjatë numërimit të votave, mirëpo nga pretendimet ankimore si dhe dëshmitë e ofruara PZAP-i nuk ka mundur që të vërtetoi se është kryer një veprim i tillë, prandaj një pretendim i tillë ankimorë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu vërtetuar, pasi që mungojnë prova bindëse me të cilat vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 1230/2013 më datën 06.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Ferit Osmani**



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.